

Të shtëna me armë zjarri në një aheng familjar në Suharekë, Policia konfiskon dy armë



01/08/2024 08:48



Policia e Kosovës ka marrë informatën mbrëmë se në fshatin Peqan të Suharekës, në një aheng familjar ka të shtëna me armë zjarri.

Njësitë policore me urgjencë thuhet të kenë dalë në vendin e ngjarjes ku edhe kanë lokalizuar të dyshuarin, H.G i lindur më 1961, mashkull kosovar tek i cili janë gjetur dhe sekuestruar në cilësinë e provave materiale dy armë.

- Armë Automatike AK-47 dhe
- Një pistoletë

"I dyshuari shoqërohet ne stacionin policor dhe pas përfundimit te procedurave ligjore me urdhër të prokurorit ndalohet për 48 orë. Rasti inicohet "–Shkaktim i rrezikut të përgjithshëm" dhe "–Mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve", thuhet në njoftimin për media.

Nga Policia u është bërë thirrje sërish qytetarëve që të mos përdorin armët gjatë gëzimeve e ahengjeve familjare, pasi si shkak i tyre shpesh herë ka pasur përfundime tragjike./Lajmi.net/



Më shumë nga uebi

nativeGRAM
by LajmiMedia



Artikuj të ngjashëm



August 1, 2024

Specialja kërkon vazhdimin e paraburgimit për Thaçin dhe Veselin



August 1, 2024

Apeli kthen në rivendosje vendimin e Themelores e cila kishte konfirmuar...



August 1, 2024

Brenda disa ditëve 39 raste aktive me COVID-19, nga IKSHPK bëhet...



August 1, 2024

Osmani uron Zvicrën për ditën kombëtare: Ke qëndruar krah për krah me ne



August 1, 2024

Skanimet me PET/CT të kufizuara nga materiali shpenzues



August 1, 2024

Udhëheqësi i Iranit urdhëron sulmin ndaj Izraelit për vrasjen e Haniyeh,...